



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

Ex-officio nr.517/2019

në lidhje me rrezikun që u kanoset qytetarëve nga qentë endacakë

### Drejtuar:

- Besian Mustafa, ministër, Ministria e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural
- Ramë Likaj, ministër, Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- Naser Krasniqi, drejtor, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
- Shpend Ahmeti, kryetar, komuna e Prishtinës
- Nexhmi Rudari, nënkryetar, komuna e Podujevës
- Burim Berisha, kryetar, komuna e Fushë Kosovës
- Agim Bahtiri, kryetar, komuna e Mitrovicës së Jugut
- Abdulhadi Krasniq, kryetar, komuna e Mamushës
- Ragip Begaj, kryetar, komuna e Malishevës
- Imri Ahmeti, kryetar, komuna e Lipjanit
- Zenun Elezaj, kryetar, komuna e Klinës
- Haki Rugova, kryetar, komuna e Istogut
- Ramiz Lladrovci, kryetar, komuna e Glllogocit
- Ardian Gjini, kryetar, komuna e Gjakovës
- Agron Kuçi, kryetar, komuna e Junikut
- Shaban Shabani, kryetar, komuna e Dragashit
- Bashkim Ramosaj, kryetar, komuna e Deçanit
- Agim Aliu, kryetar, komuna e Ferizajt
- Bekim Jashari, kryetar, komuna e Skenderajt
- Gazmend Muhaxheri, kryetar, komuna e Pejës
- Qëndron Kastrati, kryetar, komuna e Kamenicës
- Besim Ilazi, kryetar, komuna e Kaçanikut

- Rufki Suma, kryetar, komuna e Hanit të Elezit
- Lutfi Haziri, kryetar, komuna e Gjilanit
- Xhafer Tahiri, kryetar, komuna e Vushtrrisë
- Sokol Haliti, kryetar, komuna e Vitisë
- Bali Muharremaj, kryetar, komuna e Suharekës
- Naim Ismajli, kryetar, komuna e Shtimes
- Smajl Latifi, kryetar, komuna e Rahovecit
- Mytaher Haskuka, kryetar, komuna e Prizrenit
- Xhafer Gashi, kryetar, komuna e Obiliqit
- Vuçina Janković (origj. Vučina Janković), kryetar, komuna e Zveçanit
- Srgjan Vulović (origj. Srdan Vulović), kryetar, komuna e Zubin Potokut
- Bratisllav Nikoliq (origj. Bratislav Nikolić), kryetar, komuna e Shtërpçës
- Svetisllav Ivanović (origj. Svetislav Ivanović), kryetar, komuna e Novobërdës
- Zoran Todiq (origj. Zoran Todić), kryetar, komuna e Leposaviqit
- Vladica Artonović, kryetar, komuna e Ranillugut
- Dragan Petković (origj. Dragan Petković), kryetar, komuna e Parteshit
- Aleksandër Spiriq (origj. Aleksandar Spirić), nënkryetar, komuna e Mitrovicës Veriore
- Božidar Dejanović (origj. Božidar Dejanović), kryetar, komuna e Klllokotit
- Srgjan Popović (origj. Srdan Popović), kryetar, komuna e Graçanicës

**Kopje:**

- Duda Balje, kryetare, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticion
- Goran Rakiq (Goran Rakić), ministër, Ministria e Pushtetit Lokal
- Habit Hajredini, drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 2 nëntor 2020

## Qëllimi i raportit

1. Ky Raport me rekomandime (në tekstin e mëtejshëm: *Raporti*) ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së institucioneve shtetërore në trajtimin dhe ndërmarrjen e masave në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore lidhur me rrezikun nga qentë endacakë ndaj qytetarëve, në veçanti ndaj fëmijëve, përkitazi me mbrojtjen e jetës dhe për sigurinë e tyre, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare.
2. Raporti përmban rekomandime konkrete lidhur me veprimet që duhet t'i ndërmarrin institucionet përkatëse shtetërore për menaxhimin e situatës së qenve endacakë për ta evituar rrezikun ndaj qytetarëve dhe ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga shkelja e të drejtave të tyre.

## Baza ligjore

3. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/ 26 qershor 2015<sup>2</sup>, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), pos tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

3.1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);

3.2. Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);

3.3. të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

3.4. të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

3.5. t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).

## Faktet dhe rrethanat e rastit

### A. Shqetësimet lidhur me sulmet e qenve endacak ndaj qytetarëve

4. Më 7 maj 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) e ka pranuar ankesën e V. B.<sup>3</sup>, parashtruar kundër Komunës së Prishtinës (KP), përkitazi me mosndërmarrjen e masave për mbrojtjen e tij nga rreziku prej qenve endacakë. V.B. ka pohuar se më 5 maj 2019,

<sup>1</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

<sup>3</sup> A. 405/2019

rreth orës 23:40, derisa po kthehej nga puna në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë, ishte sulmuar dhe kafshuar në këmbën e djathtë nga disa qen endacakë, së paku 10 sosh. Në po atë natë, V.B. ka thënë se ishte trajtuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si pasojë e kafshimit nga qentë endacakë<sup>4</sup>.

5. Më 22 maj 2019, IAP-ja e ka pranuar ankesën e F.B.<sup>5</sup>, parashtruar kundër KP-së, përkitazi me mosndërmarrjen e masave lidhur me mbrojtjen e jetës nga qentë endacakë. F.B. ka pohuar se më 15 maj 2019, rreth orës 21:00, duke kaluar afër parkut të qytetit, ishte sulmuar dhe kafshuar nga disa qen endacakë në këmbën e djathtë. F.B. ka deklaruar se ka marrë trajtimin mjekësor në QKMF<sup>6</sup>.
6. Më 21 qershor 2019, Avokati i Popullit ka pritur në takim 20 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të komunës së Podujevës. Në këtë takim fëmijëve u dha mundësia që t'i dëgjonte Avokati i Popullit. Përveç tjerash, ata kanë thënë se ndihen të rrezikuar dhe të shqetësuar vazhdimisht për jetën e tyre nga prania e qenve endacakë.
7. Më 27 shtator 2019, Avokati i Popullit e ka vizituar Shkollën fillore “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë, ku ishte pritur nga drejtori dhe mësimdhënësit e shkollës. Në këtë takim ata e kanë njoftuar Avokatin e Popullit rreth punës dhe aktiviteteve të Shkollës fillore “Shtjefën Gjeçovi”, ku zhvillohej mësim nga nxënës të tri komuniteteve njëkohësisht (shqiptar, kroat dhe rom). Ata gjithashtu e kanë njoftuar se ndihen të rrezikuar dhe të shqetësuar vazhdimisht nga qentë endacakë.
8. Më 18 shkurt 2020, IAP-ja e ka pranuar ankesën e S.H.<sup>7</sup> lidhur me sulmin që i ishte bërë djalit të vet nga qentë endacakë. S.H. ka deklaruar se më 13 shkurt 2020, në lagjen Matiqan-Prishtinë, rreth orës 08:45, derisa po shkonte në shkollë, djali i vet që sulmuar dhe kafshuar nga disa qen endacakë, ku si pasojë e kësaj djali e ka thyer edhe dorën. Në të njëjtën natë, S.H. ka thënë se djali i vet që trajtuar në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) pas kafshimit nga qentë endacakë. Ankuesi ka pohuar se më 18 shkurt 2020, ka parashtruar ankesë edhe në KP.

## **B. Përgjegjja institucionale**

9. Më 18 qershor 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës, ka kërkuar nga KP-ja që ta informonte lidhur me veprimet që janë ndërmarrë apo që pritet të ndërmerren në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisve ligjore lidhur me çështjen, përkatësisht për mbrojtjen e qytetarëve nga rrezikimi i jetës së tyre nga qentë endacakë.
10. Më 24 qershor, 2019, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafët 4 dhe 7, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka hapur hetim sipas detyrës zyrtare “*ex-officio*” lidhur me rrezikimin e jetës së fëmijëve nga qentë endacakë në komunën e Podujevës.
11. Më 9 korrik 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës, ka kërkuar nga Komuna e Podujevës që ta informonte lidhur me veprimet që janë ndërmarrë apo që pritet të ndërmerren në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisve ligjore për këtë çështje, përkatësisht për mbrojtjen e qytetarëve nga rrezikimi i jetës së tyre nga qentë endacakë.

<sup>4</sup> Raporti i Qendrës Spitalore, 6.5.2019

<sup>5</sup> A. 444/2019

<sup>6</sup> Raporti i Qendrës Spitalore, 15.5.2019

<sup>7</sup> A. 173/2020

12. Më 23 korrik 2019, IAP-ja ka marrë përgjigje nga KP-ja: “(...) Në bazë të legjislacionit të lartcekur dhe kontratës e cila është në realizim, qentë endacakë merren në terren, trajtohen, shërohen dhe pas afatit ligjor lëshohen të lirë në vendin ku edhe janë marrë, me përjashtim të atyre kafshëve të cilat janë të rrezikshme, agresive, apo paraqesin rrezik nga ndonjë sëmundje infektive, të cilat nuk lëshohen të lirë, por trajtohen në bazë të ligjit, në mënyrë që mos të paraqesin rrezik për qytetarët (...).”
13. Më 24 gusht 2019, IAP-ja ka marrë përgjigje nga Komuna e Podujevës: “(...)Gjithashtu edhe ne si komunë ndajmë shqetësimin për këtë dukuri të shafaqur e cila për fat të keq është prezente në komunën tonë(...).Përndryshe Komuna e Podujevës në të kaluarën ka ndërmarr masa dhe veprime konkrete sa i përket parandalimit të rreziqeve nga qentë endacak, mirëpo pengesë ka qenë dhe mbetet mungesa e buxhetit për trajtimin adekuat të tyre edhe përkundër asaj që Qeveria e Kosovës ka ndarë një buxhet për trajtimin e qenve endacak, projekt i cili është zhvilluar nga Agjencia e Ushqimit dhe veterinarisë vetëm në vitin 2018, dhe që mund të konsiderohet jo efikas sepse problemi ka mbetur i njëjti. (...)”
14. Më 11 shtator 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës, ka kërkuar informata nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) lidhur me veprimet që janë ndërmarrë apo që pritet të ndërmerren në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësive ligjore lidhur me çështjen, përkatësisht për mbrojtjen e qytetarëve nga rrezikimi i jetës së tyre nga qentë endacakë.
15. Më 29 shtator 2019, IAP-ja ka marrë përgjigje nga AUV-ja: “(...) duke pasur parasysh që numri më i madh i komunave nuk e ka trajtuar këtë problematikë, Qeveria e Republikës së Kosovës si fazë emergjente ka obliguar AUV të marr përsipër zhvillimin e një programi i cili do të zgjidhte problemin në një periudhë të caktuar kohore, e që në pajtim me legjislacionin në fuqi do të bëjë: Kapjen e qenve endacakë; Trajtimin (kontroll, ushqim, vaksinim, dehelmitizim, identifikim, hospitalizim); Kastrimin/ sterilizimin; Eutanazia për qentë e sëmurë dhe agresiv kryerja e procesit të eutanazisë, transporti dhe groposja) si dhe lëshimi në vendin e kapjes për qentë në gjendje të mirë shëndetësore. (...) pas përfundimit të fazës emergjente dhe kontakteve dhe sugjerimeve të AUV, shumica e komunave të vendit nuk e kanë parë si prioritet trajtimin e problematikës së qenve endacakë.(...)”
16. Gjatë muajve janar/shkurt 2020, Avokati i Popullit, përmes shkresës, ka kërkuar informata nga komunat e Kosovës<sup>8</sup> lidhur me veprimet që janë ndërmarrë apo që pritet të ndërmerren në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësive ligjore lidhur me çështjen, përkatësisht për mbrojtjen e qytetarëve nga rrezikimi i jetës së tyre nga qentë endacakë.
17. Po ashtu, gjatë muajve janar/shkurt 2020, Avokati i Popullit ka kërkuar informata nga komunat e Kosovës<sup>9</sup> në disa pyetje konkrete, në mënyrë që t'i marhte informatat e duhura

<sup>8</sup>Komunat: Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Mamushë, Malishevë, Lipjan, Klinë, Istog, Gllogoc, Gjakovë, Junik, Dragash, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Pejë, Kamenicë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan, Vushtrri, Viti, Suharekë, Shtime, Rahovec, Prizren, Obiliq, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë, Novobërdë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Kllokot, Graçanicë.

<sup>9</sup>Komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Mamushë, Malishevë, Lipjan, Klinë, Istog, Gllogoc, Gjakovë, Junik, Dragash, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Pejë, Kamenicë, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan,

dhe të shihej pasqyra e qartë lidhur me rastin: “Çfarë ka ndërmarrë komuna e juaj për mënjanimin e problematikës së qenve endacakë? Cilat janë politikat që i zbaton komuna juaj në evitimin e rreziqeve për jetë për qytetarët nga sulmet eventuale të qenve endacakë? Cili ka qenë bashkëpunimi i juaj me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në identifikimin e qenve agresivë dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim? A ka komuna juaj Qendër të Trajtimit të Përkohshëm të Kafshëve Endacake dhe, nëse po, sa është/ janë funksionale? A ka komuna juaj vend të sigurt për hedhjen e trupave të kafshëve të ngordhura apo të atyre që vriten?”

18. Gjatë muajve shkurt/mars 2020, IAP-ja ka marrë përgjigje nga komunat<sup>10</sup> për informatat e kërkuara në pikat 16 dhe 17 të këtij raporti lidhur me çështjen.
19. Avokati i Popullit, deri në publikimin e këtij Raporti me rekomandime, nuk mori përgjigje përkitazi me këtë çështje nga komunat<sup>11</sup> për informatat e kërkuara sipas pikave 16 dhe 17 të këtij raporti. Në këtë rast këto komuna kanë dështuar të përgjigjen në kërkesat e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen në fjalë, gjë që përbën shkelje të dispozitave të Kushtetutës dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit që t’i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen<sup>12</sup>.

### C. Instrumentet përkatëse ligjore vendore dhe ndërkombëtare

20. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.” Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë: “Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”
21. Më tutje, Kushtetuta në nenin 50 (të drejtat e fëmijës) përcakton: “1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.” Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.” Kushtetuta në nenin 25 (E drejta për jetën), paragrafi 1, përcakton: “Secili gazon të drejtën për jetën.”. Ndërsa në nenin 29 përcakton: “Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë.”
22. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në vend,<sup>13</sup> në nenin 3 përcakton: “1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të

---

Vushtrri, Viti, Suharekë, Shtime, Rahovec, Prizren, Obiliq, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë, Novobërdë, Leposaviq, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Kllokot, Graçanicë.

<sup>10</sup> Komunat: Prishtinë, Glllogoc, Dragash, Ferizaj, Skenderaj, Pejë, Hani i Elezit, Gjilan, Viti, Suharekë, Shtime, Prizren, Obiliq, Shtërpçë, Ranillug, Malishevë, Graçanicë.

<sup>11</sup> Komunat: Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovica e Jugut, Lipjan, Klinë, Istog, Gjakovë, Junik, Deçan, Kamenicë, Kaçanik, Vushtrri, Rahovec, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq, Partesh, Mitrovica Veriore, Kllokot. Në mungesë të përgjigjeve nga komunat, IAP-ja ka mbledhur informata jo të drejtpërdrejta nga publikimet e OJQ-ve, të gazetave të ndryshme dhe të institucioneve të tjera.

<sup>12</sup> Neni 24, paragrafi 4, i Ligjit për Avokatin e Popullit.

<sup>13</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

jetë konsiderata mbizotëruese. 2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij (...). 3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.”

23. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: viti iii/nr. 28 qershor 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale)<sup>14</sup>, në nenin 4, përcakton: “Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, preardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.” Ndërsa neni 17 përcakton: “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë: (...) **mbrojtjen e mjedisit lokal**; (...) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut (...).”
24. Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 14 /17 korrik 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës) në nenin 1, ka për qëllim, pos tjerash: “Ta mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, nga abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, neglizhimi, apo nga ndonjë formë tjetër që e vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës”, duke marrë për bazë parimet për mbrojtjen e tij, si: të drejtën për jetë; për mbijetesë dhe zhvillim; për interesin më të mirë të fëmijës; për zhvillimin gradual të tij; për respektimin e pikëpamjes së tij dhe për mosdiskriminim.
25. Ligji nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: viti i/nr.5/01 tetor 2006 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve)<sup>15</sup>, rregullon në mënyrë të përgjithshme mbajtjen, kujdesin, strehimin, mbarështimin, transportimin dhe çështje të tjera të lidhura me përkujdesjen ndaj kafshëve. Konkretisht neni 5, paragrafi 1, i këtij ligji përcakton: “Personi që mban çfarëdo kafshe apo kujdeset për kafshën, do të jetë përgjegjës për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e saj.”
26. Po ashtu, Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, neni 6, thotë: “6.1. Mbarështimi i kafshëve duhet të bëhet sipas rregullave të përcaktuara për mbarështimin e kafshëve përfshirë metodat e mbarështimit sipas llojit dhe kategorisë së tyre në mënyrë që të njëjtat të përdoren për parandalimin e mbarështimit të pakontrolluar. 6.2. Me qëllim të zvogëlimit të popullacionit të kafshëve endacake, të rrezikshme dhe atyre të papërshtatshme për mbarështim, mund të përcaktohet steriliteti i obligueshëm i kafshës.” Tutje Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, në nenin 14, thotë: “14.1. Rezervatet, vendstrehimet e kafshëve pa pronar dhe vendstrehimet e kafshëve me pronar mund të mbahen vetë pas marrjes së licencës nga SHVUK. 14.2. Ministria do të nxjerr akt

<sup>14</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

<sup>15</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2411>

*nënligjor me të cilin përcakton mënyrën e licencimit dhe rregullimin e rezervateve, dhe vendstrehimeve të kafshëve me dhe pa pronar.”*

27. Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve parasheh edhe rastet kur qentë janë agresivë dhe të rrezikshëm jo vetëm për shëndetin, por edhe për jetën e qytetarëve, përkatësisht neni 10, paragrafi 2, përcakton: *“Kafshët agresive nuk duhet të mbahen në tufë dhe mund të vriten apo theren, kur ato paraqesin rrezik për shëndetin e kafshëve dhe të njeriut, nëse këtë më parë e vlerëson SHVUK.”*
28. Ndërsa Udhëzimi Administrativ (MBPZHR)-Nr.04/2017 për kushtet teknike të cilat duhet t'i plotësojnë qendrat e trajtimit të përkohshëm të kafshëve endacake (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi Administrativ nr.04/2017)<sup>16</sup>, përkatësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, përcakton: *“Kafshë e rrezikshme- nënkupton kafshën për të cilën ekziston dëshmia (fotografia, video) ose vlerësimi i mjekut veteriner-inspektorit të AUV që ajo kafshë për shkak të natyrës së vet gjendjes shëndetësore te saj e rrezikon shëndetin publik.”* Më tutje, neni 16, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ka paraparë se procedura e eutanazisë mund të përdoret vetëm në situatat si në vijim: *“Kafsha e kapur që është diagnostikuar nga mjeku veterinar dhe konfirmuar nga menaxheri i qendrës me sëmundje ngjitëse ose parazitare që mund të paraqesë rrezik për vetë kafshët dhe kafshët e tjera ose njerëzit në rast të lëshimit, mund të eutanazohet.”* Tutje paragrafi 2 përcakton: *“.2. Procedura e eutanazisë duhet të kryhet nga mjeku veterinar në bashkëveprim me menaxherin e qendrës dhe në kontakt me inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të siguroj që kafsha nuk do të vuajë gjatë procedurës së eutanazisë, mbetjet e saj të asgjësohen sipas legjislacionit në fuqi.”*
29. Udhëzimi Administrativ nr.04/2017, në nenin 2, paragrafët 3 dhe 4, ka përcaktuar: *“3. Komunitat janë të obliguara që të kenë qendër për trajtim të përkohshëm të kafshëve si dhe të sigurojnë vendin e vecantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura. 4. Përgjegjësimi nga paragrafi 3 i këtij neni, nëse një komunë për arsye të ndryshme nuk mund të organizojë qendrën, për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ është e obliguar që të bashkëpunojnë me komunitet fqinj.”*
30. Sipas këtij udhëzimi, neni 5 (3): *“Kapja e kafshëve endacake duhet të kryhet nga personeli i qendrës, të trajnuar për kryerjen e aktiviteteve të kapjes, në përputhje me standardet e mirëqenies së kafshëve dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës për mirëqenien e kafshëve. Qentë endacakë të gjinisë mashkullore duhet të kthehen në vendin e saktë ku janë kapur, brenda pesë (5) ditëve, ndërsa të gjinisë femrore brenda shtatë (7) ditëve. Menaxheri i qendrës do të zbatojë përgjegjësinë e trajnimit të stafit të tyre për kapjen dhe lirin e kafshëve pa shkaktuar dhimbje apo shqetësim të kafshëve.”*
31. Ligji nr. 2004/21 për Veterinarinë, neni 13, parasheh identifikimin dhe regjistrimin e qenve dhe maceve, ku thotë: *“Në pajtim me procedurat e vendosura nga Ministri, Autoritetet Komunale kryejnë: a) Regjistrimin e qenve; b) Vaksinimin vjetor kundër tërbimit dhe dehelmentizimit kundër ekinokokeve; c) Kapjen e qenve dhe maceve të rrugës dhe nëse është e nevojshme, eutanazinë e tyre; d) Largimin dhe hedhjen e sigurt e trupave të përmendura në pikën (c); e) Themelimin e vendeve për përkujdesje për qentë*

<sup>16</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15166>

*dhe macet, sipas nevojës.”*

32. Udhëzimi Administrativ nr. 12/2012 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve, në nenin 2, përcakton se fushëveprimi i udhëzimit vlen për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve të llojit të: gjedheve, deleve, dhive, derrave, njëhundraçkëve dhe të kafshëve të tjera, ku termi “kafshë tjetër” nënkupton kafshën e cila nuk është e përfshirë në termin “kafshë e fermës” (...). Më tutje, neni 19 thotë: *“Sistemi i identifikimit të kafshëve të tjera lejon regjistrimin e identitetit të këtyre kafshëve, pronave në të cilat mbahen si dhe lëvizjet e tyre. Sistemi i identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve të tjera përfshin llojet e tilla sikurse kafshët shtëpiake, të mbajtura nga personat fizikë dhe tregtarët, kafshët e mbajtura në kopshte zoologjike, panairë dhe akrobacione si dhe të gjitha kafshët e tjera të cilat mund të paraqesin kërcënim për shëndetin e kafshës dhe të njeriut.”*
33. Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - Nr.02/2018 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese parasheh regjistrimin e të gjitha kafshëve shoqëruese, që nënkupton kafshët me pronar: qentë dhe macet. Neni 3 i Udhëzimit përcakton Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë si autoritet kompetent për regjistrimin e kafshëve shoqëruese. Tutje, neni 15 thotë: *“1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ të gjitha kafshët shoqëruese të cilat nuk janë identifikuar me mikroçip duhet të identifikohen në përputhje me këtë udhëzim administrativ. 2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ menjëherë fillon edhe aplikimi i mikroçipit tek kafshët.”*

## **Analiza e çështjes**

### **A. Standardet ndërkombëtare për menaxhimin e qenve endacakë**

34. Nevoja për ta kontrolluar numrin e qenve endacakë është e motivuar nga shqetësimet e sigurisë publike dhe të shëndetit publik. Numri në rritje i qenve endacakë paraqet problem të rëndësishëm për shëndetin publik dhe të mirëqenies së njerëzve dhe të kafshëve. Rreziku nga qentë endacakë, i cili u kanoset qytetarëve, dhe në veçanti fëmijëve, është një rrezik real dhe serioz, që duhet trajtuar me kujdes nga të gjitha institucionet. Ky rrezik cenon të drejtat dhe liritë e tyre, duke filluar nga siguria, integriteti trupor e deri te shëndeti. Të drejtat dhe liritë të qytetarëve, e në veçanti të fëmijëve, mbrohen me Kushtetutë si dhe me legjislacionin e lartcekur. Rrjedhimisht, institucionet qendrore dhe lokale kanë përgjegjësi për të vepruar brenda kompetencave të tyre për ta adresuar këtë problem, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës, në pajtim me legjislacionin vendor dhe me KDF-në. Në mënyrë që të ulet ky rrezik dhe të eliminohet në tërësi, atëherë institucionet duhet të ndërmarrin masa efektive, të shpejta dhe humane për menaxhimin e qenve endacakë.
35. Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OIE) është një ndër organizatat udhëheqëse në botë për shëndetin e kafshëve, e cila rekomandohet nga Organizata Botërore e Tregtisë (WTO) kur lindin çështje dhe shqetësime lidhur me standardet e shëndetit të kafshëve<sup>17</sup>. Kjo organizatë ka përpiluar Kodin e Shëndetit të Kafshëve Tokësore (Kodi Tokësor) për përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit publik veterinar në të gjithë botën, duke përfshirë standarde për tregti të sigurta ndërkombëtare me kafshë tokësore (gjitarë, zvarranikë, zogj dhe bletë) dhe produktet e

<sup>17</sup> Shih faqen zyrtare të OIE: <https://www.oie.int/>.

tyre. Masat shëndetësore në Kodin Tokësor rekomandohen të përdoren nga autoritetet veterinare të vendeve importuese dhe eksportuese për të shërbyer për parashikim të hershëm, raportim dhe agjent kontrollues që janë patogjen për kafshët ose për njerëzit dhe për ta parandaluar transferimin e tyre përmes tregtisë ndërkombëtare të kafshëve dhe produkteve shtazore, duke shmangur barrierat sanitare të pajustificuara në tregti<sup>18</sup>. OIE-ja rregullisht i përditëson standardet e saj ndërkombëtare në pajtim me informacionet e reja shkencore, duke ndjekur procedura të përcaktuara transparente dhe demokratike. Këto standarde janë referencë edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian (BE)<sup>19</sup>.

36. Programi i Kontrollit të Popullimit të Qenve nënkupton një program me qëllim të zvogëlimit të popullimit të qenve endacakë në një nivel të veçantë dhe/ose ruajtja në atë nivel dhe administrimi i tij në mënyrë për të përmbushur një objektiv të paracaktuar.<sup>20</sup> Në mënyrë që programet për menaxhimin e situatave me qentë endacakë të jenë të suksesshme, Kodi Tokësor rekomandon dy parime udhëzuese gjatë përpilimit të këtyre programeve: 1) *Promovimi i pronësisë së përgjegjshme të qenve mund të zvogëlojë në masë të madhe numrin e qenve endacakë dhe incidencën e sëmundjeve zoonotike.* 2) *Për shkak se ekologjia e qenve është e lidhur me aktivitetet njerëzore, kontrolli i popullatës së qenve duhet të shoqërohet me ndryshime në sjelljen njerëzore që të jetë efektive.*<sup>21</sup>
37. Sipas Kodit Tokësor, pronësia e *përgjegjshme e qenve* nënkupton situatën në të cilën një person pranon dhe angazhohet të kryejë detyra të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi duke u përqendruar në përmbushjen e nevojave të sjelljes mjedisore dhe fizike të një qeni dhe në parandalimin e rreziqeve (agresiviteti, transmetimi i sëmundjeve ose i lëndimit) që qeni mund t'ia paraqesë komunitetit, kafshëve të tjera ose mjedisit.<sup>22</sup> *Ndryshimet në sjelljen njerëzore* nënkuptojnë se kur një person merr pronësinë e një qeni duhet menjëherë të pranojë përgjegjësi për atë qen dhe për çdo pasardhës që mund të ketë. Pronari duhet të sigurojë që mirëqenia e qenit, përfshirë nevojat, të respektohen dhe që qeni të mbrohet, aq sa është e mundur, nga sëmundjet infektive dhe nga riprodhimi i padëshiruar. Pronarët duhet të sigurojnë që pronësia e qenit të identifikohet qartë dhe, kur kërkohet nga legjislacioni, të regjistrohet në një bazë të dhënash të centralizuara. Të gjithë hapat e arsyeshëm duhet të merren për të siguruar që qeni nuk bredh jashtë kontrollit në mënyrë që do të paraqiste problem për komunitetin dhe për mjedisin.<sup>23</sup>
38. Programi i Kontrollit të Popullimit të Qenve nënkupton një program me qëllim të zvogëlimit të popullimit të qenve endacakë në një nivel të caktuar dhe administrimi i tij në mënyrë që të përmbushet një objektiv i paracaktuar, siç është ruajtja e sigurisë dhe e shëndetit njerëzor dhe të kafshëve. OIE-ja rekomandon që autoritetet të krijojnë një grup këshillëdhënës për zhvillimin e programit për kontrollin e popullimit të qenve, i cili duhet të përfshijë veteriner, ekspertë të ekologjisë së qenve, sjelljes së qenve dhe të sëmundjeve

<sup>18</sup> OIE, Kodi i Shëndetit të Kafshëve Tokësore (Kodi Tokësor), 2019, në: <https://www.oie.int/standard-setting/terrestrial-code/access-online/>

<sup>19</sup> BE, DG SANCO, Vlerësimi i politikës së BE-së për kafshët, Mirëqenia dhe Mundësitë e Mundshme të Politikave për të Ardhmen, 2010, në: [https://ec.europa.eu/food/sites/food/files/animals/docs/aw\\_arch\\_122010\\_full\\_ev\\_report\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/food/sites/food/files/animals/docs/aw_arch_122010_full_ev_report_en.pdf)

<sup>20</sup> Kodi Tokësor, 7.7.3.

<sup>21</sup> Kodi Tokësor, Kapitulli VII.

<sup>22</sup> Po aty, 7.7.2.

<sup>23</sup> Po aty, 7.7.4.

zoonotike dhe përfaqësuesit e palëve të interesuara përkatëse (autoritetet qendrore dhe autoritetet lokale, shërbimet/autoritetet shëndetësore, shërbimet/autoritetet e kontrollit mjedisor, OJQ-të dhe publikun). Qëllimi kryesor i këtij grupi këshillëdhënës do të ishte që ta analizonin dhe ta vlerësonin nivelin e problemit, t'i identifikonin shkaqet, ta merrte opinionin publik dhe t'i propozonin qasjet më efektive për t'u përdorur në një afat të shkurtër dhe të gjatë.<sup>24</sup>

39. Një ndër hapat e parë për adresimin e një problemi është analizimi i tij. OIE-ja këshillon që të bëhet analizimi dhe përcaktimi i nivelit të problemit, të identifikohen shkaqet dhe të propozohen qasjet më efektive për t'u përdorur në një kohë afatshkurtër dhe afatgjatë. Konsideratë të rëndësishme duhet të ketë lidhur me identifikimin e burimeve të qenve endacakë. A janë këta qen në pronësi që bredhin lirshëm, qen të braktisur nga pronarët e tyre, përfshirë këlyshët që vijnë nga mbarështimi i pakontrolluar i qenve në pronësi, qen pa pronarë që riprodhojnë me sukses apo një kombinim i këtyre opsioneve. Duhet të bëhet një vlerësim i numrit ekzistues, i shpërndarjes dhe i ekologjisë. OIE-ja e ka përpiluar edhe një metodologji tentative që mund të përdoret nga vendet e interesuara. Kjo metodologji përfshinë: regjistrimin dhe identifikimin e qenve dhe licencimin e mbarështuesve të tyre; vaksinimin kundër tërbimit dhe masa të tjera preventive kundër sëmundjeve zoonotike; procedurat veterinarë; kontrollimin e lëvizjes së qenve; kontrollimin e qenve të rrezikshëm; rregulloren për mbarështim dhe shitje të qenve; kontrollimet e ambientit; rregulloren për strehimore të qenve dhe obligimet e pronarëve dhe të autoriteteve për mirëqenien e kafshëve<sup>25</sup>.
40. OIE-ja rekomandon një kombinim të masave të ndryshme për ta menaxhuar popullimin e qenve endacakë: Edukimi dhe legjislacioni për pronësinë e përgjegjshme, regjistrimi dhe identifikimi i qenve (licencimi), kontrolli riprodhues, KSVL (kapja, sterilizimi, vaksinimi dhe pastaj lëshimi i qenve), kontrolli i lëvizjes së qenve brenda dhe jashtë vendit (eksporti/importi), rregullimi me ligj i punës së tregtarëve dhe mbarështuesve të qenve, dhe eutanazia. Sipas OIE-së, përdorimi vetëm i eutanazisë nuk është një masë efektive kontrolli, por duhet një kombinim i shumë masave për të ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për problemin. Duke i pasur parasysh këto konsiderata, është e rëndësishme që të hartohen strategji afatgjata dhe të qëndrueshme për t'u marrë me efektivitet me qentë endacakë jo vetëm për t'i mbrojtur njerëzit që janë në kontakt me këto kafshë, por edhe për t'i mbrojtur vetë kafshët dhe mirëqenien e tyre. Është gjithashtu e rëndësishme që autoritetet t'i kuptojnë qëndrimet e njerëzve ndaj pronësisë së qenve, në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë një qasje bashkëpunuese për kontrollin e popullimit të qenve.
41. Sipas OIE-së, mjetet më efektive për ta zvogëluar përhapjen apo numrin e kafshimeve të qenve janë edukimi dhe vendosja e përgjegjësisë së pronarit të qenit<sup>26</sup>. Fëmijët e vegjël janë grupi me rrezikim më të lartë nga kafshimet e qenve. Edukimi publik, pra programet e përqendruara në sjelljen e duhur të qenve janë demonstruar të jenë efektive në zvogëlimin e numrit të kafshimit të qenve dhe këto programe duhet të inkurajohen. Autoritetet duhet të kërkojnë këshilla nga ekspertë të sjelljes së qenve në zhvillimin e programeve të edukimit për sigurinë e qenve dhe mbrojtjen ndaj tyre.

<sup>24</sup> Po aty, 7.7.5.

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Po aty, pika 10.

42. Të gjitha këto masa, në mënyrë që të jenë efektive, është e rëndësishme që të monitorohen dhe të vlerësohen përgjatë të gjithë hapave të paraparë. Monitorimi dhe vlerësimi lejon krahasimin e treguesve të rëndësishëm në krahasim me bazat fillestare të matura gjatë vlerësimit fillestar<sup>27</sup>. Ata ndihmojnë në përmirësimin e performancës, duke nënvizuar problemet dhe elementet e suksesshme të ndërhyrjeve, rrisin përgjegjshmërinë për të demonstruar se programi po arrin qëllimet e tij, si dhe për ta krahasuar suksesin e strategjive të përdorura në lokacione të ndryshme dhe në situata të ndryshme. Elementet që duhet të monitorohen dhe të vlerësohen përfshijnë: madhësinë e grupit të qenve, i cili duhet të ndahet në nëngrupe në përputhje me pronësinë dhe kufizimet e lëvizjes, mirëqenien e qenve në grupin e caktuar, duke përfshirë edhe rezultatet e programeve të ndryshme, parandalimin e sëmundjeve zoonotike, sikurse tërbimin, pronësinë e përgjegjshme të kafshëve, duke përfshirë të kuptuarit e pronësisë së përgjegjshme dhe masat e sjelljeve.
43. Duhet të ceket se nuk ka asnjë direktivë ose rregullore e Bashkimit Evropian që merret me kontrollimin e qenve endacakë, pasi kjo lihet në juridiksionin e shteteve anëtare. Me problemin e kafshëve endacake tërthorazi merret traktati i vetëm ndërkombëtar që përmend kafshët shtëpiake: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Kafshëve Shtëpiake<sup>28</sup>, e cila është miratuar nga Këshilli i Evropës. Konventa kërkon të vendoset një standard themelor i përbashkët i qëndrimit dhe praktikës ndaj pronësisë së kafshëve shtëpiake. Konventa synon gjithashtu të zvogëlojë numrin e kafshëve endacake. Ndalimi i braktisjes së kafshëve shtëpiake përmendet ndër parimet kryesore për mbajtjen e kafshëve shtëpiake. Konventa përfshin masat plotësuese për kafshët endacake, të cilat synojnë në uljen e numrave të tyre. Kur numri i kafshëve endacake paraqet problem, Konventa parashikon nxjerrjen e legjislacionit të duhur dhe/ose masave administrative të nevojshme për t'i reduktuar numrat e tyre në një mënyrë që nuk shkakton dhimbje, vuajtje ose shqetësime të shmangshme. Masat e tilla përfshijnë kërkesat që nëse kafshët e tilla do të kapen, kjo bëhet me minimumin e vuajtjeve fizike dhe mendore të përshtatshme për kafshën; nëse kafshët e kapura mbahen ose vriten, kjo bëhet në përputhje me parimet e përcaktuara në Konventë. Shtetet marrin përsipër të inkurajojnë zhvillimin e programeve të informacionit dhe arsimit në mënyrë që të promovojnë ndërgjegjësimin dhe dijen për mbrojtjen e kafshëve midis organizatave dhe individëve. Në këto programe vëmendja do të tërhiqet në veçanti edhe për mbarësimin e paplanifikuar të kafshëve shtëpiake dhe rreziqet e blerjes së papërgjegjshme të kafshëve shtëpiake që çojnë në një rritje të numrit të kafshëve të padëshiruara dhe të braktisura.
44. Problemi i qenve endacakë është konsideruar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në aktgjykimin *Georgel and Georgeta Stoicescu v. Rumani*, paraqitësja e kërkesës u ankua për një sulm ndaj saj nga një turmë qensh endacakë, duke pohuar që kjo ishte për shkak të dështimit të autoriteteve për zbatimin e duhur të masave ndaj qenve të shumtë endacakë, të cilët ishin rrezik për sigurinë e banorëve. Gjykata konstatoi se mungesa e masave të mjaftueshme të marra nga autoritetet në adresimin e çështjes së qenve endacakë, së bashku me dështimin e tyre, t'i ofrojnë kompensim adekuat për

<sup>27</sup> Po aty, pika 7.7.7.

<sup>28</sup> Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Kafshëve Shtëpiake, ETS Nr. 125, në: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168007a67d>

dëmtime të qëndrueshme, paraqiti një shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit të parashikuara me nenin 8 të Konventës Evropiane për të siguruar respektimin e jetës private të paraqitëses së kërkesës.<sup>29</sup>

## B. Situata e qenve endacakë në Kosovë

45. Gjatë këtij hulumtimi, IAP-ja nuk ka gjetur asnjë raport apo hulumtim të detajuar lidhur me situatën e qenve endacakë në Kosovë, apo për numrin e tyre. Sipas një ligjërata të dhënë nga përfaqësuesi i AUV në Bukuresht në një punëtori të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, ky numër në vitin 2014 sillet rreth 9 mijë qen endacakë<sup>30</sup>. Sipas shefit të projektit “Menaxhimi dhe Mbikëqyrja e Qenve Endacakë” të implementuar nga AUV, gjatë vitit 2018, 14 mijë qen janë trajtuar në Kosovë, që do të thotë se këta qen nuk mund të riprodhojnë më, ndërsa është vlerësuar në vitin 2018 që kishte ende rreth 12 mijë qen endacakë që nuk janë sterilizuar.<sup>31</sup> Ndonëse të dhënat e sakta për numrin e qenve endacakë është vështirë të përpilohen sipas rrethanave, një llogaritje e përafërt dhe studim i problemit është i nevojshëm nga AUV si institucion përgjegjës në këtë aspekt. Vlerësimet e popullimit të qenve endacakë janë të nevojshme për të bërë plane reale për menaxhimin dhe kontrollin e tyre dhe për monitorimin e suksesit të ndërhyrjeve.
46. Nga shtatë masat e rekomanduara nga OIE, Kosova aktualisht aplikon vetëm dy plotësisht: atë të KSVL (kapja, sterilizimi, vaksinimi dhe pastaj lëshimi i qenve); dhe eutanazisë dhe pjesërisht pjesën e legjislacionit, kontrollit riprodhues dhe kontrollit të lëvizjes së qenve. Këto masa nuk janë të mjaftueshme për të menaxhuar me efikasitet popullimin e qenve endacakë dhe për ta mbajtur atë nën kontroll, duke i parandaluar rreziqet për shëndetin dhe për mirëqenien e njeriut.
47. Për ta adresuar dukurinë e qenve endacakë, me rëndësi është që të zhvillohet menaxhimi i kontrolluar i popullimit të qenve, i cili mungon në Kosovë. Menaxhimi i popullimit të qenve shihet si një problem shoqëror, me një varg sjelljesh njerëzore si shkaktar rrënjësor. Qëllimi përfundimtar duhet të jetë një situatë në të cilën të gjithë qentë janë në pronësi të përgjegjshme. Qëndrimet dhe kujdesi ndaj qenve ndryshojnë në varësi të qëndrimeve kulturore dhe individuale. Si rezultat, duhet të synohet zbatimi i legjislacionit dhe vendosja e ndërhyrjeve edukative për t'i adresuar këto qëndrime dhe për t'i përmirësuar standardet e mbikëqyrjes dhe kujdesit ndaj qenve, kështu që masat e kontrollit të jenë efektive në sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm për njerëzit dhe për qentë.
48. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve lejon regjistrimin, mirëpo nuk e detyron atë. Udhëzimi Administrativ (MBPZHR)- Nr.02/2018 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese parasheh regjistrimin e të gjitha kafshëve shoqëruese, që nënkupton se kafshët shoqëruese dhe mbajtësit e tyre (pronarët) në Kosovë duhet të identifikohen dhe të regjistrohen. Por zbatimi i këtij udhëzimi ende është i mangët. Përgjashtimisht, Komuna e Vushtrrisë është e vetmja e cila

<sup>29</sup> *Georgel and Georgeta Stoicescu v. Rumani*, Aplikacioni no. 9718/03, GJEDNJ, 26 korrik 2011, para. 62.

<sup>30</sup> Shih Kallxo.com, Qentë Endacakë-Rreziku dhe Problemet me Strehimore, Ligj e Inspektore, 05.03.2015, në: <https://kallxo.com/gjate/qente-endacake-rreziku-dhe-problemet-me-strehimore-ligj-e-inspektore/>.

<sup>31</sup> <https://prishtinainsight.com/14315-2/#:~:text=%E2%80%9C14%2C000%20dogs%20have%20been%20treated,dogs%20can%20no%20longer%20reproduce.&text=It%20is%20estimated%20that%20there,this%20year%2C%E2%80%9D%20said%20Taraku.>

ka nxjerrë rregullore të veçantë: Rregullore (K.Vu) 01.Nr.87/15 për Kushtet e Mbajtjes së Qenve dhe Maceve si dhe mënyrën e Veprimit në Rast të Braktisjes ose Humbjes së Tyre, me të cilën i obligon pronarët t'i regjistrojnë qentë dhe macet<sup>32</sup>. Regjistrimi i qenve me pronarë është i rëndësishëm ngase këta qen janë një ndër burimet e qenve endacakë për shkak të braktisjes së tyre apo bredhjes nëpër rrugë pa përkujdesje dhe të pa sterilizuar/kastruar.<sup>33</sup> Në mënyrë që të adresohen të gjitha burimet e qenve endacakë, duhet të regjistrohen edhe qentë me pronarë<sup>34</sup>. Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve shtëpiake do të ndihmonte për të ndaluar fenomenin mizor të braktisjes së qenve dhe për të zvogëluar popullimin e qenve endacakë. Gjithashtu do ofronte më shumë siguri për shëndetin publik. .

49. Ndonëse ekziston Udhëzimi Administrativ Ma-Nr. 04/2005 për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës për Mbarështimin e Kafshëve, Certifikimin e Personave dhe Organizatave që Ndërmarrin Aktivitete në Mbarështimin e Kafshëve, ky udhëzim rregullon kryesisht kafshët në fermë dhe jo kafshët shoqëruese si qentë edhe macet<sup>35</sup>. IAP-ja nuk ka gjetur të dhëna të cilat tregojnë se ka regjistër dhe mbikëqyrje të mbarështuesve të këtyre kafshëve. Mbarështuesit dhe tregtarët e kafshëve duhet të rregullohen me legjislacion dhe të mbikëqyren për të inkurajuar angazhim për rritjen dhe shitjen e qenve të shëndetshëm fizikisht dhe psikologjikisht, sepse qentë jo të shëndetshëm kanë më shumë të ngjarë të braktisen për t'u bërë pjesë e grupit të qenve endacakë<sup>36</sup>. Gjithashtu, mbarështuesit dhe tregtarët duhet të japin këshilla për kujdesin e duhur për të gjithë pronarët e rinj të qenve për të kontribuar në këtë aspekt.
50. Kosova nuk përfshin edukim lidhur me qentë endacakë në kuadër të sistemit arsimor (përjashtimisht disa iniciativave të izoluar)<sup>37</sup>. Gjithashtu mungon edukimi dhe fushatat për pronësinë e përgjegjshme të qenve. Ky edukim duhet të shënjestrojë pronarët e qenve si dhe fëmijët nëpër shkolla lidhur me sjelljen e qenve dhe kujdesin ndaj qenve endacakë. Edukimi i pronarëve të qenve lidhur me pronësinë e përgjegjshme duhet të adresojë regjistrimin dhe identifikimin e qenve, trajnimin si dhe kontrollin e riprodhimit të qenve, sepse pronarët shpeshherë lëshojnë këlyshët e padëshiruar. Pronarët mund të inkurajohen për t'i sterilizuar qentë e tyre përmes tarifave të ndryshme të licencimit, siç ka bërë Komuna e Vushtrrisë, e cila për qentë e sterilizuar/kastruar ka vënë tarifë vjetore vetëm 5 euro, në krahasim me qentë e pasterilizuar/kastruar ku tarifa vjetore është 30 euro. Inkurajimi i pronarëve të qenve për të qenë më të përgjegjshëm do të zvogëlojë numrin e qenve bredharakë, të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e qenve dhe të minimizojë rrezikun që qentë paraqesin për komunitetin. Për të arritur një zhvendosje drejt pronësisë së përgjegjshme, është e nevojshme të përdoret një ndërthurje e legjislacionit dhe

<sup>32</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11911>

<sup>33</sup> Shih: Kosovo 2.0, Si i trajton Kosova qentë endacakë, 29.04.2017, në: <https://kosovotwopointzero.com/street-dogs-life/>.

<sup>34</sup> Prandaj shumica, për të mos thënë gati të gjitha vendet e zhvilluara, duke përfshirë këtu edhe vendet e BE-së, i regjistrojnë qentë me pronarë: (<http://www.carodog.eu/identification-and-registration/countries-where-identification-and-registration-of-dogs-is-mandatory/>).

<sup>35</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7259>

<sup>36</sup> Kodi Tokësor, Kapitulli 7.7.

<sup>37</sup> Shembull organizata zvicerane StrayCoco në Gjakovë: <https://www.straycoco.com/willkommen/aus-und-weiterbildung/>.

vetëdijesim publik<sup>38</sup>. Ndërhyrjet për të ndryshuar sjelljen njerëzore duhet të përshtaten me kujdes për popullatën e synuar si me metodologji të ndryshme për moshën të ndryshme.

51. Edukimi për legjislaionin gjithashtu luan një rol të rëndësishëm për mbrojtje dhe sjelljen ndaj qenve endacakë. Edukimi duhet t'i synojë të gjitha nivelet, nga organet e zbatimit të ligjit (policia dhe inspektorët e mirëqenies së kafshëve) deri tek profesionistët përkatës (veterinerët dhe menaxherët e strehimoreve) si dhe pronarët e qenve dhe publiku i gjerë.
52. Po ashtu, nevojiten njohuri më të mira për dinamikën e popullimit të qenve endacakë, duke përfshirë një kuptim të marrëdhënieve midis transmetimit të sëmundjeve dhe densitetit të kafshëve, qarkullimit të popullsisë së qenve endacakë dhe lëvizshmërisë së tyre. Këto të dhëna mund të sigurohen në nivelin komunal. Të njëjtat të dhëna të plotësuar me informacion mbi praktikën e mbajtjes së qenve në përgjithësi dhe mundësitë e vaksinimit dhe trajtimit të qenve do të kontribuojnë shumë në hartimin e suksesshëm të programeve të kontrollit specifik të qenve endacakë.
53. Komunitat gjithashtu duhet të vazhdojnë me projektet e KSVL-së në mënyrë të vazhdueshme, siç është bërë në këto vitet e fundit sipas AUV, dhe jo vetëm në situata të cilat konsiderohen emergjente,<sup>39</sup> për ta mbajtur nën kontroll popullimin e qenve endacakë dhe me kalimin e kohës në uljen e konsiderueshme të këtij popullimi. Projektet duhet të monitorohen dhe vlerësohen kohë pas kohe për t'i parë rezultatet dhe situatën reale të gjendjes së popullimit të qenve endacakë. Kjo do të ndihmojë në efikasitetin e programeve, uljen e rrezikut, përmirësimin e llogaridhënies dhe shërbimet e ofruara.
54. Rrjedhimisht, komunitat duhet të ofrojnë siguri për qytetarët nga qentë endacakë. Pra, neni 17 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcakton se komuna ka përgjegjësi në mbrojtjen e mjedisit lokal, mjedis ky në të cilin jetojnë dhe veprojnë të gjitha qeniet e gjalla. Gjithashtu në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndër më të rëndësishmet janë: **e drejta e jetës, lirisë dhe sigurisë si dhe të drejtat e fëmijës**. Në veçanti lidhur me të drejtat e fëmijës, institucionet obligohen ta kenë parasysh interesin më të mirë të tyre gjatë ndërmarrjes së çfarëdo veprimeve dhe masave, me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit të fëmijës, në pajtim edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Mirëpo, krahas mbrojtjes së të drejtave të njeriut, detyrë e secilës komunë është edhe përkujdesja për qeniet e tjera të gjalla, në vështrim të pikës e, të nenit 17.

## Konstatimet

55. Pas rishikimit të legjislaionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që IAP-ja i ka, del se në rastin konkret, *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirisë themelore të njeriut*, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve pasi që autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës në lidhje me ndërmarrjen e të gjitha masave për mbrojtjen e qytetarëve nga rreziku që u kanosej nga qentë endacakë.
56. Avokati i Popullit vëren se përkundër përpjekjeve të disa komunave në përballimin me

<sup>38</sup> Kodi Tokësor, Kapitulli 7.7.

<sup>39</sup> AUV, Qentë endacakë po trajtohen në të gjithë Kosovën, 2018, në: <https://www.auv-ks.net/sq/aktivitete/qente-endacak-po-trajtohen-ne-te-gjithe-kosoven>

problemin e trajtimit të qenve endacakë, gjendja nuk ka ndryshuar shumë në mungesë të një plani kombëtar dhe koordinimi ndër-komunal dhe ndër-institucional për ta adresuar këtë problem.

57. Avokati i Popullit konsideron se, para se të përpilohet një plan kombëtar për ta adresuar problemin e qenve endacakë, është thelbësore që të bëhet një analizë për ta kuptuar dhe matur objektivisht dinamikën e popullimit të qenve endacakë. Menaxhimi i efektshëm i grupit të qenve do të ketë pak sukses nëse mungon një kuptim i qartë i shumëllojshmërisë së faktorëve të përfshirë. Duhet të vërtëtohet cila është madhësia e grupit të qenve endacakë, cilat janë burimet e tij, pse ekzistojnë këto burime dhe çfarë është ndërmarrë për t'i kontrolluar qentë endacakë. Është e rëndësishme të vlerësohet jo vetëm se çfarë është bërë në të kaluarën, por edhe çfarë është duke u bërë aktualisht për të kontrolluar popullimin e qenve, në mënyrë që të nxirren konkluzione në lidhje me përpjekjet e mëparshme të kontrollit, duke i vlerësuar ato burime që janë në dispozicion për ndërhyrjet e ardhshme dhe për qëndrueshmërinë e tyre. Kjo qasje siguron që programi përfundimtar i menaxhimit do t'i përshtatet nevojave dhe karakteristikave të popullatës lokale të qenve, duke shmangur një ndërhyrje të vetme për të gjitha situatat.
58. Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e strehimit për qentë endacakë është problem serioz në nivel vendi dhe komunat nuk kanë qendër për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017, dhe shumica e komunave nuk kanë të siguruar vendin e veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura.
59. Avokati i Popullit vëren se legjislacioni vendor ka ende nevojë për plotësim për të adresuar dhe për të përmirësuar reagimin institucional në menaxhimin e situatës së qenve endacakë, siç është edhe rregullimi i rezervateve, vendstrehimeve të kafshëve pa pronarë dhe vendstrehimet e kafshëve me pronarë.. Legjislacioni gjithëpërfshirës është element kryesor në adresimin adekuat të problemit dhe qëndrueshmërinë e programeve dhe në arritjen e qeverisjes së mirë. Po ashtu mungon zbatimi i duhur i legjislacionit për të siguruar respektimin e dispozitave ligjore dhe suksesin e ndërhyrjeve.
60. Avokati i Popullit ka vërejtur se edukimi luan një rol të rëndësishëm në uljen e kafshimeve nga qentë dhe se Kosova nuk ka programe edukative për mbrojtje dhe sjelljen ndaj qenve endacakë, si dhe programe vetëdijesuese për pronësinë e përgjegjshme të qenve, të cilat mund të zvogëlojnë në masë të madhe numrin e qenve endacakë dhe incidencën e sëmundjeve zoonotike.
61. Avokati i Popullit konsideron se institucionet shtetërore do të duhej të kishin bërë më shumë për mbrojtjen e qytetarëve, përkatësisht për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziku që u kanosej nga qentë endacakë duke ndërmarrë një kombinim të masave të ndryshme të cilat do të menaxhonin grupin e qenve endacakë dhe uljen e numrit të sulmeve. Çdo metodë që përdoret duhet të bazohet në pikëpamjet etike dhe sipas legjislacionit, duke shmangur vuajtjet e qenve.
62. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“(…) ka përgjegjësi të*

*tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla (...)."*

Prandaj, Avokati i Popullit i

## **REKOMANDON**

### **Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

1. Ta nxjerrë aktin nënligjor, me të cilin do ta përcaktojë mënyrën e licencimit dhe të rregullimit të rezervateve dhe vendstrehimeve të kafshëve me dhe pa pronarë, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, duke i marrë parasysh edhe kompetencat funksionale të AUV-së, sipas Rregullores Nr.01/2011 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

### **Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës**

1. Të organizojë fushata edukimi për mbrojtje dhe sjelljen ndaj qenve endacakë përmes shpërndarjes së fletushkave, librave informativë apo përmes vizitave në orët mësimore të ekspertëve për sjelljen e kafshëve. Fushatat mund të organizohen në bashkëpunim me OJQ-të dhe përmbajtja e të dhënave të jetë e hartuar nga ekspertë në fushën e sjelljes së qenve.

### **Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë**

1. Ta zbatojë Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr.02/2018, si autoritet kompetent, që parasheh regjistrimin e të gjitha kafshëve shtëpiake, në mënyrë që mbarështuesit, mbajtësit e kafshëve, dyqanet e kafshëve dhe të tjerët që merren me kafshë shtëpiake shoqëruese të identifikohen dhe regjistrohen në nivel shteti.
2. Organizimin e fushatave vetëdijesuese për pronarët e qenve lidhur me pronësinë e përgjegjshme si dhe sterilizimin/kastrimin e qenve.

### **Komunës së Prishtinës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Podujevës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Fushë Kosovës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Mitrovicës së Jugut**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Mamushës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Malishevës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Lipjanit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Klinës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Istogut**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Glllogocit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Gjakovës**

1. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Junikut**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Dragashit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Deçanit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Ferizajt**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Skenderajt**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Pejës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Kamenicës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Kaçanikut**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Hanit të Elezit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Gjilanit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Vushtrrisë**

1. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Vitisë**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Suharekës**

1. Ta krijojë dhe të funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Shtimes**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Rahovecit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Prizrenit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Obiliqit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Zveçanit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Zubin Potokut**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Shtërpçës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Novobërdës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Leposaviqit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Ranillugës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Parteshit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Mitrovicës Veriore**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Killokotit**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

### **Komunës së Graçanicës**

1. Ta krijojë dhe ta funksionalizojë qendrën për trajtim të përkohshëm të kafshëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.
2. Ta sigurojë një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr.04/2017.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderim,

  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit